



C.nr.481/13

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Ardian Ajvazi dhe procesmbajtesja Minire Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të inicuar me padinë e paditëses [REDACTED] Prishtinë, kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Ferizaj, baza e kontestit kthimi i huasë-kredisë, jashtë seance me datë 28.09.2015, merr ket:

A K T G J Y K I M

-PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES-

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] Prishtinë, si e bazuar.

DETYROHET i padituri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Ferizaj, që paditëses t'ia kompensojë shumën prej **2,484.28€** (dymijë e katërqindë e tetëdhjetë e katër e njëzet e tetë cent), në emër të kthimit të kredisë, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 22.07.2013 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi e nën kërkcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjyaktë ka ushtruar padi me datë 22.07.2013, kundër të paditurit, për kthimin e kredisë në shumën prej **2,484.28€**. Paditësja ia ka dhënë në shfrytëzim kredinë të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj në shumën prej 3,000.00€ me normën e interesit prej 12.9% nga dita e lejimit të kredisë.



Paditësja, Gjykatës i ka bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera materiale për kredidhënje përkatësisht kredimarrje nga palët ndërgjygjëse.

Gjykata, të paditurit, me datë 24.08.2015, i ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri [REDACTED] në afatit të përcaktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi nuk ka dhënë përgjigje në padi, nëse e kundërtshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si duke patur parasysh faktin se i padituri ka pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata bazuar ne nenin 150.6 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.481/13, datë 28.09.2015

Gjyqtari,
Arifan Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme nga pranimit i këtij Aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS

VEKENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

2017